

# Hepatiti viral

Njohuri aktuale, mbrojtje dhe trajtim



Udhëzues | në dispozicion në 15 gjuhë



Das Gesundheitsprojekt  
Mit Migranten  
für Migranten

Ethno-  
Medizinisches  
Zentrum e.V.



## IMPRESSUM

### Hepatiti viral – Njohuri aktuale, mbrojtje dhe trajtim

Botues:

Ethno-Medizinisches Zentrum e. V.  
Königstraße 6, 30175 Hannover | Gjermani  
info@ethnomed.com | www.ethnomed.com | www.mimi-bestellportal.de

Stafi editorial dhe sigurimi profesional i cilësisë:

Ramazan Salman, Matthias Wentzlaff-Eggebert, Dr. Matthias Wienold,  
Ahmet Kimil, Michael Kopel

Përkthim: Dolmetscherdienst Ethno-Medizinisches Zentrum e. V.

Të drejtat e autorëve të fotografive: Fotografia e faqes së titullit © Rawpixel Ltd/  
istock.com, faqja 6 © ag visuell/stock.adobe.com, faqja 7 © bluebay2014/  
stock.adobe.com, faqja 8 © Rostislav Sedlacek/stock.adobe.com, faqja 9  
© XtravaganT/stock.adobe.com, faqja 10 © Tobias Arhelger/stock.adobe.com,  
faqja 12 © bagi1998/istock.com, faqja 13 © Nomad/istock.com,  
faqja 14 © BlackJack3D/istock.com, faqja 14 © dra\_schwartz/istock.com,  
faqja 16 © senoldo/stock.adobe.com, faqja 17 © Guido Grochowski/istock.com

Mundesitë e porosisë së kopjeve të shtypura:

Online: www.ethnomed.com | www.mimi-bestellportal.de  
Me E-Mail: bestellportal@ethnomed.com | info@ethnomed.com  
Me shkrim: Ethno-Medizinisches Zentrum e. V., Königstraße 6, 30175 Hannover

Ky udhëzues është në dispozicion në gjuhët në vijim:

Shqip, arabisht, bullgarisht, gjermanisht, anglisht, farsi, frëngjisht, italisht,  
kurdisht, polonisht, rumanisht, rusisht, serbo-kroatisht, spanjisht, turqisht

Botimi i parë

Dhjetor 2018

Ky udhëzues ka për qëllim një publik të gjerë. Për të siguruar korrektësinë e përbajtjes, të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Një tjetër përdorim se sa në kuadrin ligjor të definuar kërkon miratim paraprak me shkrim nga Ethno-Medizinisches Zentrum e. V. Ju lutem na shkruani.

Falënderojmë kompaninë  
MSD SHARP & DOHME GMBH  
për mbështetjen miqësore në  
realizimin e kësaj broshure.





Hepatiti i shkaktuar nga një infeksion viral është një problem shëndetësor i përhapur dhe shpesh i nënvlerësuar. Disa forma nuk shkaktojnë ankesa të menjëhershme, por mund të kenë efekte serioze të vonuara. Lajm i mirë është se në disa raste këto mund të parandalohen nëpërmjet vaksinimit, zbulimit të hershëm dhe trajtimit. Kush është i informuar mirë, mund ta mbrojë veten më mirë.

Ky udhëzues mbi hepatitin është zhvilluar nga Ethno-Medizinisches Zentrum e.V. Ne do të ishim të kënaqur, nëse ky udhëzues do të ndihmojë, dorë për dorë bashk me ju, për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit tuaj. Ne jemi kufizuar në faktet më kryesore të mjekësisë. Në rastin konkret, gjithmonë biseda me mjekun/mjekën tuaj absolutisht është gjëja më e rëndësishme për të sqaruar pyetje të mëtejshme. Në fund do të gjeni adresat e vendeve, që mund të ndihmojnë më tej.

**Prof. Dr. Gisela Fischer**  
**Ramazan Salman**

**Shoqata e regjistruar Qendra Etno-Mjekësore**



# Përmbajtja

<b>1</b>	Hyrje .....	5
<b>2</b>	Mëlçia .....	6
<b>3</b>	Çfarë është hepatiti? .....	7
<b>4</b>	Hepatiti A.....	9
<b>5</b>	Hepatiti B.....	11
<b>6</b>	Hepatiti C.....	13
<b>7</b>	Hepatiti D.....	16
<b>8</b>	Hepatiti E .....	17
<b>9</b>	Fjalor* (Shprehjet më të rëndësishme profesionale) .....	18
<b>10</b>	Shënime.....	19

\* Në tekst janë disa fjalë në shkrim kursiv. Ato mund t'i gjeni me sqarim të shkurtër duke filluar nga faqja 18 në fjalorin/kapitullin „Shprehjet më të rëndësishme profesionale“.


# 1 Hyrje

Për shkak se hepatiti *viral* si pasojë mund të shkaktojë dëmtime shëndetësore, masa paraprake/preventive dhe zbulimi i hershëm janë të rëndësishme. Nëse ju i njihni rrugët dhe rreziqet e transmetimit, ju mund të mbron veten dhe mund të kujdeseni, që infeksionet me viruset e hepatitit të zbulohen dhe trajtohen herët. Ky udhëzues përmban informacione mbi format e ndryshme të hepatitit viral, të masave mbrojtëse dhe mbi testet, si dhe informacione për trajtim dhe mbështetje.

Tek infeksioni i hepatitit një *virus* futet në trup dhe shkakton ndryshime që e bëjnë personin e infektuar të sëmurë. Organizma të ndryshëm infektive infektojnë pjesë të ndryshme të trupit, në rast të hepatitit preket mëlçia. Hepatiti përhapet kryesisht nga personi në person ose nëpërmjet ushqimit të ndotur.

Viruset e hepatitit janë të përhapur në rajone të ndryshme të botës dhe gjerësia e shpërndarjes së tyre ndryshon sipas rajoneve. Prandaj tek vlerësimi i rrezikut tuaj personal është me rëndësi të merrni parasysh gjithashtu origjinën tuaj dhe udhëtimet tuaja. Me këtë broshurë ne dëshirojmë të ju japim informacione të vlefshme, se si të mbron vetën nga një infeksion me *viruse* të hepatitit dhe çfarë mund të bëhet në rast të një sëmundjeje.

Mëlçia është organi metabolik më i rëndësishëm i trupit të njeriut. Ajo shtrihet në barkun e sipërm të djathtë. Çdo gjë që trupi përmes zorrës merr në gjak transportohet në mëlçi. Pjesët përbërëse të ushqimit të marrë aty konvertohen ose ruhen, kështu që ato i shërbejnë organeve të tjera.



Ilustrimi/Figura: Mëlçia si një organ qendror i gjithë metabolizmit

Ndër detyrat më të rëndësishme të mëlçisë është prodhimi i proteinave, të cilat pastaj lëshohen në gjak sipas nevojës. Shpërbërja e proteinave gjithashtu ndodh në mëlçi. Mëlçia edhe shërben si një organ ruajtje të sheqerit, i cili nuk nevojitet menjëherë (ruajtje e glukozës) dhe formon lëngun e tëmthit për tretje. Përveq kesaj në mëlçi formohen substanca të rëndësishme yndyrore për trupin, si dhe deponohen vitamina, të cilat lëshohen sipas nevojës. Mëlçia është

gjithashtu e përfshirë në formimin e *hormoneve* të rëndësishme, të cilat për shembull na nevojiten për rritjen.

Mëlçia është edhe organi ynë më i madh i detoksifikimit. Substanca të dëmshme si për shembull alkooli dhe nikotina së pari hyjnë në mëlçi, e cila i thyen toksinat në komponente të padëmshme. Prandaj shumë substanca (p.sh. alkooli) mund të dëmtojnë mëlçinë.


## 3

## Çfarë është hepatiti?

Hepatiti do të thotë “inflamacion i mëlçisë” (nga hepar = greqisht për mëlçi). Shkaqet mund të jenë veç infeksioneve *virale* edhe çrregullime metabolike ose helmime, p.sh. përmes alkoolit. Nga qelizat e mëlçisë të dëmtuara lëshohen pastaj *enzima*, ndër të tjera të ashtuquajturit transaminaza. Rritja e transaminazave të mëlçisë në gjak është një tregues i rëndësishëm i hepatitit.

Dëmtimi i mëlçisë mund të shkaktojë një çrregullim të metabolizmit. Mbledhja e produkteve të tretura mund të shihet dukshëm si ngjyrim i verdhë i lëkurës ose i së bardhës së syrit. Në këtë rast flitet për një verdhëz (ikteri). Sepse

me hepatit edhe metabolizmi i energjisë mund të jetë i çrregulluar, kjo mund të shkaktojë një ndjenjë të përgjithshme të dobësisë.



Shkaku më i zakonshëm i hepatitit është infeksioni me viruse të hepatitit A, B, C, D ose E. Shkaqet më të zakonshme jo-infektive janë konsumimi i alkoolit, çrregullimet e metabolizmit të yndyrave/lipideve dhe efektet anësore të medikamenteve.

## SIMPTOMET E PËRGJITHSHME TË HEPATITIT JANË:

- Shtypje në barkun e sipërm të djathtë
- Ndjenjë e përgjithshme e të qenit sëmurë dhe/ose temperaturë e lehtë
- anoreksi, të përzier dhe ndjenjë fryrje
- Zverdhje e lëkurës dhe e pjesës së bardhë të syrit si dhe ngjyra e urinës e errët
- Iritim/kruarje të lëkurës, ne disa raste acarim i lehtë i lëkurës

Por mbi të gjitha pasqyra e *enzimave* të mëlçisë në gjak është tregues i një hepatiti të mundshëm. Një ekzaminim mjekësor duke kërkuar me duar ose një ekzaminim me ultratinguj mund të zbulojë një zgjerim të mëlçisë. Duke përcaktuar *antitruapat* përkatës dhe komponentët *virale* në gjak, mund të konfirmohet ose të përjashtohet hepatiti viral. Nëse shkaku është i paqartë ose për të vlerësuar shkallën e dëmtimit të mëlçisë, mund të jetë e nevojshme të merret një mostër e indeve të trupit ("biopsi").

Kundër hepatitit A dhe B ju mund të vaksinoheni. Nëse keni pasur ndonjëherë rrezik të infektimit për hepatitin C, atëherë duhet të testoheni, sepse sot hepatiti C mund të shërohet. Në këtë mënyrë mund të parandalohen pasojat e mundshme të mëvonshme, si për shembull cirroza e mëlçisë ose kanceri i mëlçisë.

## KU OFROHEN TESTIMET DHE TRAJTIMI PËR HEPATIT?

- Në disa lande federale refugjatët dhe azilkërkuessit në regjistrimin e parë testohen për hepatitin B dhe C.
- Oferta të testimit për hepatit B për shërbim/kujdes mjekësor të nënës dhe për përçatitjen për lindje.
- Njerëzit që kanë pasur rrezik të infeksionit mund të testohen pranë ordinancës së mjekut të familjes.
- Për sqarimin e shenjave të caktuara të sëmundjes një testim i hepatitit mund të jetë i nevojshëm, edhe nëse nuk keni njohuri për rrezikun e infeksionit.
- Testimet falas dhe anonime gjithashtu mund të kryhen pranë autoriteteve shëndetësore dhe qendrave të këshillimit.
- Për profesionistë të përcaktuar, punëdhënësi paguan testimin të kryer nga mjeku i kompanisë, p.sh. kur jeni të punësuar në spitale. Në rastin e një infeksioni të fituar duke kryer detyrën e profesionit, sigurimi ligjor i aksidentit paguan shërbimin mjekësor.

Ju gjithmonë do të trajtoheni nga një mjek/një mjeke. Për sëmundjet e mëlçisë si hepatiti janë të specializuar hepatologët/hepatologet.





Virusi i hepatitit A (HAV) shkakton sëmundjen e hepatitit A, simptomat e saj nuk janë të ndryshme nga ato të formave të tjera të hepatitit viral. Virusi i mbijeton gjithashtu temperaturat e larta si dhe shumë dezinfektues dhe është përhapur në mbarë botën. Hepatiti A është më i zakonshmi në vendet në zhvillim. Atje shumë njerëz tashmë sëmuren në fëmijëri apo adoleshencë. Kundër hepatitit A mund të vaksinoheni.

### TRANSMETIMI DHE MBROJTJA

Virusi i hepatitit A sekretohet me feçe/fekale dhe mund të hyjë nëpërmjet gojës në trup. Prandaj ju mund të infektoheni kryesisht nëpërmjet ujërave ose konsumimit të ushqimit të fëlliqur nga ujërat e ndotura, por edhe për shkak të mungesës së higjienës ose të kontakteve seksuale.

### RRUGËT E ZAKONSHME TË TRANSMETIMIT JANË:

- ushqimi dhe uji i pijshëm i ndotur
- objekte sanitare të pamjaftueshme
- larja e pamjaftueshme e duarve
- kontaktet seksuale, sidomos kontaktet anal-orale.

### NJË RREZIK TË RRITUR PRANDAJ KANË:

- udhëtarët në zona, ku hepatiti A është shumë i përhapur
- punonjësit të kujdesit shëndetësor
- njerëzit të cilët në profesionin e tyre duhet të merren me ujërat e ndotura
- meshkujt që kanë marrëdhënie seksuale me meshkuj.



**Kundër hepatitit A ka një vaksinë, mbrojtja e saj zgjat shumë vite. Ajo rekomandohet për të gjitha grupet me rrezik. Në disa raste kompania e sigurimeve shëndetësore ose punëdhënësi merr përsipër kostot. Pyetni dhe merrni vaksinën në rastin e dhënë.**

Higjiena shtëpiake normale dhe mirëmbajtja e kujdesshme e ushqimeve parandalon shumicën e infeksioneve, përfshirë hepatitin A. Pra lani duart pas çdo përdorimi të tualetit si dhe para përgatitjes së ushqimit dhe para se të hani bukë, dhe lani frutat dhe perimet e freskëta me kujdes.

Nëse punoni profesionalisht në kujdesin/ shërbimin shëndetësor ose merreni me ujërat e zeza, ju jeni të detyruar të ndiqni rregullat higjienikë që ju mbrojnë nga transmetimi. Nëse nuk jeni të sigurt, pyetni punëdhënësin ose sindikatën tuaj.

## DIAGNOZA DHE TRAJTIMI


Sidomos tek fëmijët, infeksioni shpesh kalon pa u vënë re. Por pas 15 – 50 ditësh mund të shfaqen simptomat tipike të hepatitit. Njerëzit e moshuar kanë më shpesh simptoma të rënda.

Nëse keni hepatit A të shëruar, ju jeni të mbrojtur (imun) kundër një sëmundjeje të re. Shumë rrallë sëmundja kalon në një ecuri të rëndë me dështim të mëlçisë.

Në rast të simptomave të hepatitit bëhet testimi i rritjës së vlerave të funksionit të mëlçisë. Prova e *antitropave* mund të tregojë një infeksion të kaluar dhe një infeksion aktual.

Virusi i hepatitit A vetë aktualisht nuk mund të luftohet me medikamente. Trajtimi shërben për të mbështetur trupin në procesin e shërimit, deri sa simptomat si për shembull temperaturë, të përziera dhe vjellje zhduken.

Kjo do të thotë që ju duhet të mënjanoi çdo gjë që vendos një tendosje në mëlçi (alkool, medikamente të caktuara) dhe të pini mjaftueshëm ujë.



Virusi hepatiti B (HBV) shkakton një nga sëmundjet e hepatitit më të zakonshme në botë, por intensiteti i përhapjes së tij ndryshon sipas rajoneve të ndryshme. Shumica e të rriturve shërohen tërësisht nga infeksioni *akut* i hepatitit B. Ata zakonisht janë të mbrojtur përjetshëm kundër një infeksioni të ri (imun). Megjithatë në 5 – 10% të të rriturve dhe më shpesh tek fëmijët e vegjël, virusi mbetet i vërtetueshëm në gjak për më shumë se gjashtë muaj. Atëherë flitet për një hepatit *kronik* B. Kundër hepatitit B ju mund të vaksinoheni.

### TRANSMETIMI DHE MBROJTJA

Virusi transmetohet kryesisht nga një person i infektuar në një person jo të infektuar me gjak, por gjithashtu edhe lëngje të tjera trupore si pëshnymë, lëngje seminale dhe sekrecione vaginale. Rreziku i infeksionit gjatë marrëdhënies normale me njëri-tjetrin dhe në familje është i ulët.

### RRUGËT E ZAKONSHME TË TRANSMETIMIT JANË:

- Kontakte seksuale
- Përdorimi i përbashkët i gjilpërave/agave nënllëkurore dhe shiringave të injektimit në përdorimin e drogës
- Bërja e pirsing, e tatuazheve dhe e rrojës *jo sterile*
- Procedurat mjekësore jo sterile, p.sh. në të kaluarën ose në rajonet me higjienë të dobët
- Nga nëna tek fëmija gjatë lindjes.

### NJË RREZIK TË RRITUR PRANDAJ KANË:

- Meshkuj që kanë marrëdhënie seksuale me meshkuj
- Personat që kanë shumë partnerë seksualë (femër ose mashkull)
- Njerëzit që përdorin drogë në mënyrë intravenoze
- Njerëzit në burgim
- Staf mjekësor që merret me gjak
- Fëmijët e nënave të infektuara.

Nëse vini nga një rajon i botës ku infeksioni i hepatitit B është shumë i zakonshëm, ju mund të jeni bartës i virusit të hepatitit B pa e ditur atë. Këto rajone përfshijnë mbi të gjitha Azinë, Pacifikun e Jugut, rajonin subsaharian, Amerikën e Jugut dhe Lindjen e Mesme. Por edhe në rajonin e Mesdheut dhe në Evropën Lindore, njerëzit me antitropa të hepatitit B janë shumë më të zakonshëm se në Gjermani.

Pra, bëni testimin dhe trajtohuni nëse është e nevojshme.

Të sapolindurit, të cilët infektohen gjatë lindjes, janë veçanërisht të prirur të zhvillojnë hepatitin kronik B. Transmetimi gjatë lindjes mund të parandalohet duke vaksinuar foshnjën menjëherë pas lindjes. Prandaj është e rëndësishme që nënat të testohen para lindjes. Në Gjermani prandaj testimi është me ligj i përcaktuar në udhëzimet për mbrojtjen e lindjes.

Kush ka hepatit kronik B, mund të infektojë të tjerët. Në kontaktet seksuale ju mbroni veten me prezervativë. Kur përdorni drogë, mos i përdorni veglat/instrumentet e injektimit së bashku. Shumë organizata humanitare dhe qendra për këshillim për njerëzit, që përdorin drogë, ofrojnë pajisjet e injektimit *sterile*. Mos përdorni aparat berberi/të rrojës, gërshtë thonjsh dhe furça dhëmbësh së bashku.

## DIAGNOZA DHE TRAJTIMI

Rreth një e treta e të prekurve nuk kanë ankesa fare. Në rast të hepatitit B akut së pari shfaqen simptoma si anoreksi, dhimbje të nyjave, të qenit pa qejf, të përzier/vjellje ose ethe. Pas 3 deri në 10 ditë mund të shfaqet zverdhja e lëkurës dhe urina bëhet e errët. Shumë pak njerëz sëmuren seriozisht dhe eventualisht pësojnë një humbje të funksionimit të mëlçisë. Më shumë se 90% e të rriturve shërohen tërësisht dhe pa pasoja të mëtejshme.

Tek infeksionet në moshën e fëmijërisë është tërësisht e ndryshme – mbi 90% zhvillohen në hepatitin kronik B. Kjo do të thotë, se komponentët e virusit mbeten të vërtetueshme në gjak për më shumë se gjashtë muaj.

Tek hepatiti kronik B rreziku për *fibrozë të mëlçisë* dhe *cirrozë* është me i lartë. Këto ndikojnë negativisht në funksionin e mëlçisë. *Cirroza* gjithashtu rrit rrezikun e kancerit të mëlçisë.

Vlerat e rritura të funksionit të mëlçisë janë një tregues të hepatitit të mundshëm B. Për të qenë i sigurt testet e gjakut janë të nevojshme. E rëndësishme është dallimi midis hepatitit akut dhe kronik B, sepse infeksioni kronik është tregues i pasojave afatgjata. Heqja e indit të mëlçisë (biopsi e mëlçisë) mund të jetë e nevojshme për të vlerësuar dëmtimin e mëlçisë.

Persona me hepatit B kronik zakonisht marrin trajtim antiviral. Sidomos nëse virusi shtohet fort ose inflamacioni i mëlçis është ndezur ose tashmë është dëmtuar.



Hepatiti C shkaktohet nga virusi i hepatitit C (HCV). Tek virusi i hepatitit C bëhet dallimi midis varianteve të ndryshme, të ashtuquajturit *gjenotipet*. Ato janë të përhapura në rajone dhe grupe të popullatave të ndryshme në intensitet të ndryshëm. Një vaksinë për mbrojtje nuk ekziston.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 1,75 milionë njerëz në mbarë botën infektohen rishtas me virusin e hepatitit C çdo vit. Numri i të infektuarve kronik supozohet në 71 milionë. Për shkak të pasojave të mundshme të mëvonshme kjo është një temë e rëndësishme shëndetësore: Mesatarisht një e katërta e personave të infektuar me hepatit kronik C zhvillojnë *cirrozën e mëlçisë*

pas deri 20 vjetësh, disa dhe kancer të mëlçisë. Kështu shtohet rreziku për të qenë i varur nga transplantimi i mëlçisë.

Sot hepatiti kronik C mund të shërohet me medikamente në 95% të rasteve. Pra testohuni, nëse keni pasur ndonjëherë rrezik për hepatitin C.






## TRANSMETIMI DHE MBROJTJA

Virusi i hepatitit C transmetohet kryesisht përmes kontaktit gjak-në-gjak. Mjafton kur një sasi shumë e vogël e gjakut të infektuar të hyjë në sistemin e qarkullimit të gjakut të një personi të pa infektuar. Transmetimi seksual është i rrallë, por i mundur – sidomos nëse ndodhin lëndime të lehta gjatë seksit. Hepatiti C nuk transmetohet nëpërmjet qumështit të gjirit, duke ngrënë së bashku, duke pirë së bashku apo përmes kontakteve sociale.

## RRUGËT E ZAKONSHME TË TRANSMETIMIT JANË:

- Përdorimi i përbashkët i gjilpërave, shiringave, tubave dhe veglave për injektim gjatë konsumit intravenoz të drogës si dhe nuhatjes/thithjes nazale (përmes hundës) të drogës
- Seksi i pambrojtur, sidomos tek meshkujt që kanë seks me meshkuj
- Procedurat mjekësore *jo-sterile*, në të kaluarën ose në rajonet me higjienë të dobët (sidomos nga përdorimi i shumëfishtë i gjilpërave dhe shiringave, p.sh. në fushatat e vaksinimit ose në mjekësinë e stomatologjisë)
- Transfuzionet e gjakut para aplikimit të programeve të testimit të gjakut dhe nënprodukteve të tij për praninë e hepatitit C (në Gjermani para vitit 1992).





## NJË RREZIK TË RRRITUR PRANDAJ KANË:

- Personat që përdorin drogë në mënyrë intravenoze ose të nuhatjes/thithjes nazale (përmes hundës)
- Meshkujt që kanë seks me meshkuj
- Njerëzit në burgim
- Personat që kanë marrë gjak apo produkte të gjakut të pakontrolluara, transplantime ose hemodializë (në Gjermani para vitit 1992)
- Njerëzit nga rajonet me përhapje më të lartë të infeksionit më HCV (Afrika, Azia Qendrore dhe Lindore).

Një vaksinë kundër hepatitit C nuk ekziston. Në kontaktet seksuale ju mbroni veten me prezervativë. Kur përdorni drogë, mos i përdorni veglat e injektimit së bashku. Shumë organizata humanitare dhe qendra këshillimi, për njerëzit, që përdorin drogë, ofrojnë pajisjet e injektimit *sterile*. Mos përdorni aparat të rrojës, gërshtëre thonjsh dhe furça dhëmbësh së bashku.

## DIAGNOZA DHE TRAJTIMI

Rreth në një të tretën e rasteve trupi kapërcen virusin zakonisht pa simptoma. Nëse jo, hepatiti C bëhet kronik. Edhe në këte rast nuk shfaqen simptoma ose kryesisht vetëm të buta. Por pas 20 deri 25 vjetësh me hepatit kronik C, mes 2 dhe 35% të të prekurve fillimisht zhvillojnë një *fibrozë të mëlçisë* dhe më vonë eventualisht një *cirrozë të mëlçisë*. Mëlçia atëherë gjithnjë e më shumë humb funksionin e saj. Ndërsa rreth 2–5% e këtyre personave zhvillojnë kancer të mëlçisë çdo vit.

Testi i parë për hepatitin C është një test i gjakut, ku kërkohen antitruapat. Megjithatë këta gjinden edhe në gjakun e individëve, që kanë kapërcyer virusin në menyre të natyrshme, ose që janë shëruar përmes trajtimit. Prandaj është e rëndësishme të bëhet një test tjetër i gjakut, në rast që testi i parë del pozitiv dhe tregon praninë

e antitruapave. Këtu materiali gjenetik i virusit (*ARN*) vetë mund të identifikohet në gjak (testi *ARN*). Heqja e indit të mëlçisë (biopsi e mëlçisë) mund të jetë e nevojshme për të përcaktuar fazën e dëmtimit të mëlçisë.

Hepatiti C kronik duhet të trajtohet pas mundesisë sa më herët, sepse rreziku i pasojave të mëvonshme rritet gjithnjë e më shumë me moshën dhe progresin e sëmundjes. Qëllimi i trajtimit është që virusi të eliminohet përherë nga trupi.

Deri pak vite më parë hepatiti C mund të trajtohej vetëm me një kombinim të medikamentit *Interferon* dhe medikamenteve të tjera. Kjo formë trajtimi zgjati për muaj, kishte efekte anësore të forta dhe kishte në varësi të llojit të virusit sukses të ndryshëm.

Që nga viti 2011 medikamente të reja gradualisht janë miratuar, të cilat ndërhyjnë në procesin e shumëzimit të virusëve. Në këtë mënyrë trajtimi është më i shkurtër, shumë më mirë i toleruar dhe i suksesshëm në mbi 95% të rasteve. Edhe nëse trajtimi juaj i mëparshëm ishte i pasuksesshëm, sot ju keni një shans shumë të mirë për shërim. Në parim hepatiti kronik C duhet gjithmonë të trajtohet për të parandaluar cirrozën dhe kancerin e mëlçisë. Nëse jeni të prekur, informoni veten në ordinancën mjekësore tuaj të specializuar dhe tek organizatat e përmendura në fund të këtij udhëzuesi.

Ndryshe nga disa infeksione të tjera, hepatiti C i shëruar nuk jep imunitet. Pra ju mund të infektoheni përsëri dhe duhet të mbroni veten në përputhje me rrethanat.

Virusi i hepatitit D (ose virusi delta) gjendet vetëm në kombinim me virusin e hepatitit B. Hepatiti D është i përhapur në rajone të ndryshme të botës dhe gjerësia e përhapjes së saj ndryshon sipas rajoneve. Kur të sëmurët me hepatit B përveç kësaj infektohen edhe me virusin e hepatitit D, ecuria e sëmundjes mund të keqësohet më rëndë e më shpejt, më një rrezik më të madh për cirrozë të mëlçisë dhe për kancer të mëlçisë.

### TRANSMETIMI DHE MBROJTJA

Ashtu si hepatiti B hepatiti D transmetohet kryesisht përmes kontakteve të gjakut në gjak. Transmetimi nga lëngjet trupore dhe kontaktet me mukozën është gjithashtu i mundur, p.sh. tek kontaktet seksuale. Vaksinimi efektiv i hepatitit B gjithashtu parandalon infeksionin e hepatitit D. Edhe nëse keni pasur dikur hepatit B, e cila është shëruar, ju jeni imun.

Masat mbrojtëse për hepatitin B gjithashtu vlejné për hepatitin D. Pra mënjanoni përdorimin e përbashkët të aparatave të rrojes, gërsërëve të thonjëve, dhe furçave të dhëmbëve, si dhe shiringave dhe gjilpërave në konsumin e drogës dhe përdorni prezervativë. Virusit i hepatitit D është i përhapur në rajonin e Mesdheut, në Lindjen e Mesme, në Pakistan, në Azinë Qendrore dhe Veriore, në Japoni, në Tajvani, në Grenlandë

si dhe në vendet e Bririt të Afrikës, në Afrikën Perëndimore, në pellgun e Amazonës dhe disa rajone të Paqësorit.

Kjo është arsyeja pse mbrojtja është veçanërisht e rëndësishme, nëse tashmë keni hepatit B kronik dhe doni të udhëtoni në këto zona. Bisedoni planet tuaja të udhëtimit më kohë me mjekun/ me mjeken tuaj.

### DIAGNOZA

Në rast të një infeksioni të njëkohshëm me hepatitin B dhe D shpesh nuk shfaqen simptoma fare. Por mund të shfaqen ankesat tipike të hepatitit. Të prekurit zakonisht shërohen tërësisht, dhe vetëm në rreth 5 % të rasteve sëmundja kalon në sëmundje kronike. Rreziku është më i madh, kur të sëmurët me hepatit B kronik përveç kësaj infektohen edhe me virusin D. Këtu në 70–90 % të rasteve ecuria e sëmundjes kalon rëndë dhe çon më shpejtë në cirrozën e mëlçisë.





*Gjenotipet* e ndryshme të virusit të hepatitit E, që shkaktojnë këtë hepatit, janë të përhapura në rajone të ndryshme të botës. Shumica e sëmundjeve të shkaktuara përmes ujit të ndotur nga fekalet ndodhin në Azinë Juglindore dhe Qendrore, Afrikën Veriore dhe Perëndimore, në Amerikën Qendrore dhe Lindjen e Mesme. Në Gjermani rastet e hepatitit E janë rritur shumë.

Zakonisht infeksioni akut shërohet në vetvete. Por për gratë shtatzëna dhe pacientët e mëlçisë mund të jetë i rrezikshëm për jetën. Te personat me imunitet të dobët (për shembull, ata që kanë marrë një transplantim, marrin dializë, ose janë HIV pozitiv) zhvillohet më shpesh hepatiti kronik E.

### TRANSMETIMI DHE MBROJTJA

Ashtu si tek hepatiti A transmetimi zakonisht ndodh nëpërmes ujit ose ushqimeve të ndotura nga fekalet njerëzore, në Gjermani ndoshta nëpërmjet ushqimit të mishit të gjallë të derrit apo të derrit të egër. Në Gjermani nuk lejohet vaksinimi për mbrojtje. Kur udhëtoni në rajonet, ku është i njohur shpërthimi e hepatitit E, ju mund të informoheni paraprakisht për rrezikun dhe të keni kujdes për ujë të pastër të pijshëm dhe ushqim të pastër. Edhe në Gjermani është e këshillueshme për të ngrënë vetëm mish të zier ose pjekur mirë.

### DIAGNOZA DHE TRAJTIMI

Nëse fare, atëherë shfaqen zakonisht 14 deri në 60 ditë më vonë simptoma që janë tipike për hepatit. Përveç kësaj në disa raste vërehen ankesa të sistemit nervor. Tëk gratë shtatzëna, sidomos në tremujorin e fundit të shtatzënisë, si dhe te pacientët e mëlçisë, hepatiti E mund të kalojë shumë rëndë dhe në 20% të rasteve çon në vdekje. Kur personat me funksion të imunitetit të reduktuar zhvillojnë hepatitin kronik E, kjo mund të çojë pa trajtim në një kohë relativisht të

shkurtër (disa vjet) në cirrozë të mëlçisë. Së pari gjaku testohet për antitropa të hepatitit E. Nëse ka dyshim për një sëmundje kronike, është i mundur testimi i materialit gjenetik të virusit nëpërmes gjakut apo jashtëqitjes.

Një trajtim i veçantë i hepatitit E nuk është i miratuar në Gjermani, por vazhdon të hulumtohet. Por nganjëherë përdoren medikamente kundër simptomave.



**Akut**

Në rast sëmundjesh: shfaqet dhe zhvillohet në mënyrë të menjëhershme, të shpejtë e të rëndë

**Antitrupa**

Antitruapat formohen nga sistemi imunitar për të neutralizuar agjentet patogjen të futura në trup. Ato janë individualisht të përshtatura për patogjenin. Antitruapat në gjak prandaj shërbejnë si vërtetues që një infeksion i caktuar është shfaqur. Në disa raste kur trupi njëherë kapërcen agjentin patogjen, trupi fiton imunitet afatgjatë kundër tij.

**ARN**

Acidi ribonukleik (ARN) është materiali që përbëhet nga materiali gjenetik i viruseve të caktuara (viruse të ARN-së). Testet e ARN-së mund të identifikojnë dhe matin ARN-në e viruseve të ndryshme në gjak.

**Cirroza e mëlçisë**

Zhvillohet nga fibroza e mëlçisë. Nëpërmjet formimit të ndryshimeve nodular, plagëve dhe shkatërrimit në rritje të strukturës së qelizave të mëlçisë, mëlçia humb gjithnjë e më shumë funksionin e saj.

**Fibroza e mëlçisë**

Te fibroza e mëlçisë qelizat e vdekura të mëlçisë zëvendësohen me ind lidhës. Struktura lobulare e mëlçisë dhe enët e gjakut, që kalojnë përmes saj, fillimisht mbeten të pandikuara.

**Enzima**

Substanca ndihmëse të formuara nga trupi për përshpejtimin e reaksioneve kimike. Këto kanë një funksion të rëndësishëm kontrolli të metabolizmit.

**Gjenotipi**

Gjenotipi i një organizmi të gjallë është variant i materialit gjenetik të tij. Individët e të njëjtit specie mund të kenë gjenotipet me devijime të vogla që mund të ndikojnë në karakteristikat e tyre. Viruset gjithashtu mund të ekzistojnë në variante të ndryshme gjenotipike, të cilat mund të ndikojnë për shembull në ecurinë dhe trajtimin e sëmundjes.

**Hormon**

Një substancë/lajmëtar kimik që prodhohet nga qelizat e trupit dhe e cila në organin e synuar stimulon efekte ose funksione të caktuara.

**Interferon**

Interferonët janë substanca të formuara nga vetë trupi, të cilat formohen për mbrojtje kundër viruseve dhe tumoreve. Interferonët të prodhuar artificialisht përdoren si një medikament në rast të sëmundjeve virale. Trajtimi me interferon shpesh ka efekte anësore të padëshirueshme.

**Kronik**

Në rast sëmundjesh: e qëndrueshme, zhvillohet ngadalë e nuk shërohet për kohë të gjatë

**Steril/jo-steril**

Steril do të thotë pa sëmundjeshkaktues/patogjen. Pajisjet dhe materialet e përdorura në ndërhyrjen e trupit të njeriut duhet të bëhen steril (sterilizohen) nëpërmjet ngrohjes ose proceseve kimike. Jo-steril do të thotë, se mungesa e patogjenëve/ sëmundjeshkaktuesve nuk është e garantuar.

**Virus/virale**

Viruset janë grimca infektive, të cilave u nevojitet qeliza pritëse të një organizmi të gjallë për të u shumfishuar. Ato janë të përbërë nga një veshje e jashtme dhe nga materiali gjenetik brenda saj. Shumë sëmundje infektive janë të shkaktuara nga viruset, gjithashtu hepatiti viral. Sistemi imunitar i njeriut lufton kundër viruseve ndër të tjera nëpërmes antitrupave.



# Hepatiti viral

Njohuri aktuale, mbrojtje dhe trajtim

## NDIHMË DHE KËSHILLË NË RAST TË SËMUNDJEVE TË MËLÇISË

Fondacioni gjerman i mëlçisë (Deutsche Leberstiftung) është themeluar në vitin 2006. Qëllimi i saj është përmirësimi i vazhdueshëm i zbulimit të hershëm dhe trajtimit të sëmundjeve të mëlçisë. Për pacientët dhe të afërmit, Fondacioni gjerman i mëlçisë ofron informacion dhe këshillim në çështjet mjekësore.

**Deutsche Leberstiftung**  
**Carl-Neuberg-Straße 1, 30625 Hannover**  
[www.deutsche-leberstiftung.de](http://www.deutsche-leberstiftung.de)

Fondacioni gjerman për ndihmë të mëlçisë (Deutsche Leberhilfe) i lidh mjekët e specializuar dhe interesat për vetë-ndihmë. Ai informon dhe jep sqarime. Në disa qytete njerëzit me hepatit (ose sëmundje të tjera të mëlçisë) janë bashkuar në grupe. Si grupe vetë-ndihme ato gjithashtu i përkasin fondacionit gjerman për ndihmë të mëlçisë (Deutsche Leberhilfe).

**Deutsche Leberhilfe e.V.**  
**Krieler Straße 100, 50935 Köln**  
[www.leberhilfe.org](http://www.leberhilfe.org)

## INFORMACIONET AKTUALE LIDHUR ME HIV

Shoqata e regjistruar Qendra Etno-Mjekësore (Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.) si pjesë e projektit të AIDS & Mobility ka publikuar një broshurë mbi HIV/SIDA me partnerë nga gjashtë vende evropiane.

<http://www.aidsmobility.org/326.0.html>

## LINKET NDËRKOMBËTARE TË INTERNETIT

Aleanca Botërore e Hepatitit i ka vendosur vetes qëllimin e ndalimit të përhapjes dhe sëmundjes së hepatitit B dhe C. Çdo vit organizon Ditën Botërore të Hepatitit. Si një organizatë ndërkombëtare publikon opinionin e saj në anglisht, frëngjisht, arabisht, kinezisht, rusisht, spanjisht dhe portugalisht.

[www.worldhepatitisalliance.org](http://www.worldhepatitisalliance.org)